

URDHËR
Nr. 327, datë 12.7.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, “PËR NDALIMIN
E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 12.7.2021” zëvendësohet me togfjalëshin deri në datën 26.7.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**